

AKT-MARRËVESHEJË datë 28 Shtator 2021

ndërmjet

LORIN BURBA

(i biri i Gramos dhe Naime, lindur më 27.06.1989, në Tiranë, Shqipëri, me adresë banimi: Rr. Dalip Topi, L. Qesarakë, P. Zaimaj, Shk. 1, Ap. 23, Tiranë, Shqipëri, i identifikuar përmes Kartës së Identitetit Nr. 036408473, Nr. Personal I90627101A, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në vijim referuar si "DHURUESI")

∅

FRANCI BODE

(i biri i Alfred dhe Edlira, lindur më 29.06.1989, në Berat, Shqipëri, me adresë banimi: Rr. Qamil Guranjaku, L. 1, P. 4, Shk. 3, Ap. 41, Tiranë, Shqipëri, i identifikuar përmes Pasaportës me Nr. BD0889076, Nr. Personal I90629076B, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në vijim referuar si "PËRFITUESI")

MEQËNËSE:


- (i) Dhuruesi dhe Përfituesi (në vijim "PALËT"), më datë 04.06.2018, kanë krijuar së bashku shoqérinë me përgjegjësi të kufizuar "BODE FOOTBALL MANAGEMENT SH.P.K." (regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS: L81805050N, me seli në Rr. Dalip Topi, L. Qesarakë, P. Zaimaj, Shk. 1, Ap. 22-25, Tiranë, Shqipëri), me vlerë kapitali themeltar 1,000 (një mijë) lekë, me pjesëmarrje në kapitalin themeltar nga Palët në përqindjet e mëposhtme:
 - 90 % (nëntëdhjetë përqind) nga Përfituesi;
 - 10 % (dhjetë përqind) nga Dhuruesi;
- (ii) Dhuruesi ka vullnetin për kalimin e kuotave të tij në favor të Përfituesit;
- (iii) Përfituesi pranon kalimin e kuotave të Dhuruesit në favorin e tij,

Në përputhje me Nenet 761-771 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Nenit 68 e vijues të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), Palët bien dakord si vijon:

- (1) Dhuruesi, me vullnetin e tij të, i dhuron Përfituesit pjesën e tij (kuotën) të kapitalit themeltar të shoqërisë me përgjegjësi "Bode Football Management sh.p.k.", me vlerë përkatëse 100 (njëqind) lekë, e cila përfaqëson 10 % (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, pa kundërshpërbirim dhe me efekt të menjëhershëm.
- (2) Me nënshkrimin e kësaj aktmarrëveshje, Palët bien dakord se Përfituesi do të jetë i vetmi person i cili zotëron kuotat (ose kuotën) e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Bode Football Management sh.p.k." në masën 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar.
- (3) Palët bien dakord se të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga pjesëmarrja në kapitalin themeltar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara "Bode Football Management sh.p.k." për të gjithë kohëzgjatjen e ortakërisë ndërmjet tyre, do të janë në ngarkim të Përfituesit.
- (4) Me nënshkrimin e kësaj aktmarrëveshje, Dhuruesi merr përsipër të nënshkruajë vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Bode Football Management sh.p.k." për miratimin e aktmarrëveshjes dhe kalimin e pjesës së tij në favor të Përfituesit.
- (5) Kjo aktmarrëveshje nënshkruhet në 3 (tre) kopje, nga 1 (një) kopje e së cilës do të mbahet nga Palët dhe kopja e tretë do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- (6) Për çfarë nuk është parashikuar në këtë aktmarrëveshje, Palët do t'i referohen legjisacionit shqiptar në fuqi.
- (7) Kjo aktmarrëveshje u hartuar në 1 (një) faqe dhe përmban 8 (tetë) dispozita.
- (8) Të gjitha mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj aktmarrëveshje do t'i referohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nënshkruar në Tiranë, më 28 Shtator 2021

DHURUESI
Lorin Burba



PËRFITUESI
Franci Bode

